



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 43, datë 20 .11. 2012

PËR

“MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR PROGRAMIN E SUBVENCIONIMIT TË FAMILJEVE QË PËRFITOJNË KREDI TË LEHTËSUARA NGA SHTETI, SISTEMIN E PIKËZIMIT PËR PROGRAMIN E BANESAVE SOCIALE ME QIRA DHE SISTEMIN E PIKËZIMIT PËR BONUSIN E STREHIMIT”.

Në mbështetje të nenit 7, pika 1, neni 10, pika 2, shkronja “g”, neni 32, shkronja “k” të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); neni 3, pikat 1 dhe 2, neni 5, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 9232, datë 13.05.2004 për “Programet sociale të strehimit” (i ndryshuar); neni 8 dhe 124 të ligjit nr.8485, date 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar); pika 6 e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 574, datë 29.08.2012 për “Përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqesë familja për t’u strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”; të udhëzimit nr. 6257, datë 02.09.2008 mbi “Përcaktimin e masës së subvencionimit për familje që përfitojnë kredi të lehtësuar nga shteti”, (i ndryshuar); vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 29, datë 28.12.2011 për “Një ndryshim në vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 63, datë 08.11.2005, “Për miratimin e komisionit të strehimit” (i ndryshuar), ju paraqesim për shqyrtim materialin e mëposhtëm:

V E N D O S I

1. Të miratojë sistemet e pikëzimit për programin e subvencionimit të familjeve që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti, sistemin e pikëzimit për programin e banesave sociale me qira dhe sistemin e pikëzimit për bonusin e strehimit, si më poshtë:

- a) Sistemi i pikëzimit për programin e subvencionimit të familjeve që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti (Tabela I)
- b) Sistemi i pikëzimit për programin e banesave sociale me qira (Tabela II)
- c) Sistemi i pikëzimit për trajtimin sipas bonusit të strehimit (Tabela III)

TABELA I - SISTEMI I PIKËZIMIT PËR PROGRAMIN E SUBVENCIONIMIT TË FAMILJEVE QË PËRFITOJNË KREDI TË LEHTËSUARA NGA SHTETI

	KRITERET E PIKËZIMIT	Pikët
1.1	KUSHTET E STREHIMIT	30
A	Nuk disponon apartament në pronësi	

B	Banojnë në banesa në rrezik shembje	
C	Banojnë në banesa të mbipopulluara, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi	
Ç	Kanë ngelur ose rrezikojnë të ngelen të pastreha, si rezultat i fatkeqësive natyrore, ose zbatimit të një vendimi gjyqësor;	
1.2	KUSHTET FAMILJARE	20
A	Familje një prindërore që kanë në ngarkim fëmijë	
B	Të moshtau që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për t'u strehuar nga institucionet publike të përkujdesit shoqëror	
C	Familjet me më shumë se katër fëmijë	
Ç	Çiftet e reja me moshë totale deri 60 vjeç	
1.3	KUSHTET SOCIALE	20
A	Persona me aftësi të kufizuar	5
B	Persona me statusin e jetimit që nga çasti i daljes nga qendrat e përkujdesit shoqëror e deri në moshën 30 vjeç	2
C	Emigrant i kthyer, punëtor emigrant	2
Ç	Familjet e policëve të rënë në detyrë	5
D	Viktima të dhunës në familje	3
E	Komuniteti Rom dhe Egjipian	3
1.4	KUSHTET EKONOMIKE	30
A	Të ardhura nën 80% të të ardhurave mesatare	
B	Të ardhura deri 80%- 100% të të ardhurave mesatare	
C	Të ardhura 100%- 120% të të ardhurave mesatare	

TABELA II - SISTEMI I PIKËZIMIT PËR PROGRAMIN E BANESAVE SOCIALE ME QIRA

	KRITERET E PIKËZIMIT	Pikët
1.1	KUSHTET E STREHIMIT	30
A	Nuk disponon apartament në pronësi	
B	Banojnë në banesa në rrezik shembje	
C	Banojnë në banesa të mbipopulluara, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi	
Ç	Kanë ngelur ose rrezikojnë të ngelen të pastreha, si rezultat i fatkeqësive natyrore, ose zbatimit të një vendimi gjyqësor;	
1.2	KUSHTET FAMILJARE	20
A	Familje një prindërore që kanë në ngarkim fëmijë	
B	Të moshtau që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për t'u strehuar nga institucionet publike të përkujdesit shoqëror	
C	Familjet me më shumë se katër fëmijë	
Ç	Çiftet e reja me moshë totale deri 60 vjeç	

1.3	KUSHTET SOCIALE	20
A	Persona me aftësi të kufizuar	5
B	Persona me statusin e jetimit që nga çasti i daljes nga qendrat e përkujdesit shoqëror e deri në moshën 30 vjeç	2
C	Emigrant i kthyre, punëtor emigrant	2
Ç	Familjet e policëve të rënë në detyrë	5
D	Viktima të dhunës në familje	3
E	Komuniteti Rom dhe Egjipian	3
1.4	KUSHTET EKONOMIKE	30
A	Të ardhura nën 80% të të ardhurave mesatare	
B	Të ardhura deri 80%- 100% të të ardhurave mesatare	
C	Të ardhura 100%- 120% të të ardhurave mesatare	

TABELA III - SISTEMI I PIKËZIMIT PËR TRAJTIMIN SIPAS PROGRAMIT TË BONUSIT TË STREHIMIT

	KRITERET E PIKËZIMIT	Pikët
1.1	KUSHTET E STREHIMIT	30
A	Nuk disponon apartament në pronësi	
B	Banojnë në banesa në rrezik shembje	
C	Banojnë në banesa të mbipopulluara, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi	
Ç	Kanë ngelur ose rrezikojnë të ngelen të pastreha, si rezultat i fatkeqësive natyrore, ose zbatimit të një vendimi gjyqësor;	
1.2	KUSHTET FAMILJARE	20
A	Familje një prindërore që kanë në ngarkim fëmijë	
B	Të moshtau që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për t'u strehuar nga institucionet publike të përkujdesit shoqëror	
C	Familjet me më shumë se katër fëmijë	
Ç	Çiftet e reja me moshë totale deri 60 vjeç	
1.3	KUSHTET SOCIALE	20
A	Persona me aftësi të kufizuar	5
B	Persona me statusin e jetimit që nga çasti i daljes nga qendrat e përkujdesit shoqëror e deri në moshën 30 vjeç	2
C	Emigrant i kthyre, punëtor emigrant	2
Ç	Familjet e policëve të rënë në detyrë	5
D	Viktima të dhunës në familje	3
E	Komuniteti Rom dhe Egjipian	3
1.4	KUSHTET EKONOMIKE	30
A	Të ardhura nën 80% të të ardhurave mesatare	

B	Të ardhura deri 80%- 100% të të ardhurave mesatare	
C	Të ardhura 100%- 120% të të ardhurave mesatare	

Në llogaritjen e pikëve për familjet përfituese nga tre programet e zbatuara nga Bashkia e Tiranës, Komisioni i Strehimit duhet të marrë në konsideratë rregullat e mëposhtme:

I. Pikët maksimale që mund të përfitojë një familje janë 100. Nuk mund të mblidhen brenda për brenda një kriteri pikët:

1. Nga A deri në Ç të kriterit 1.1 - Kushtet e strehimit;
2. Nga A deri në Ç të kriterit 1.2 - Kushtet familjare ; dhe
3. Nga A deri në C të kriterit 1.4 - Kushtet ekonomike.

II. Pikët nga A deri në D të kriterit 1.3 mund të mblidhen me njëra-tjetrën sipas rasteve më poshtë:

1. Pika A mund të mblidhet me njërin prej rasteve si më poshtë:

- a) Me pikat B dhe Ç së bashku ose veçmas;
- b) Vetëm me pikën C;
- c) Vetëm me pikën D.

2. Pika B mund të mblidhet vetëm me pikën A.

3. Pika C mund të mblidhet vetëm me pikën A.

4. Pika Ç mund të mblidhet me pikat A e B së bashku ose me njëren prej tyre. Në total mbledhja e pikëve A, B e Ç nuk duhet të rezultojë më e lartë se 20 pikë.

2. Vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 51, datë 19.12.2008 për “Miratimin e sistemit të pikëzimit për bonusin e strehimit dhe sistemit të pikëzimit për subvencionimin e familjeve që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti”, revokohet.

3. Ngarkohet Drejtoria e Menaxhimit të Strehimit dhe Shërbimeve Sociale, për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

Niazi KOSOVRASTI